TRIBUNA SINDIKALE

Shtator 2008

Dhe drit e diturisë
përpara do na shpjerë





Editorial

OBJEKTIVAT SINDIKALE PER VITIN E RI SHKOLLOR

Shtatori eshte muaji qe shenon fillimin e cdo viti te ri mesimor. Edhe kete vit gjysme milioni femije dhe te rinj deri ne moshen 18 vjec, qe nga klasa e pare e ciklit te ulet te shkolles 9 - vjecare e deri ne vitin e fundit te shkolles se mesme, u japin gjalleri e jete shkollave te sistemit parauniversitar ne te gjithe Shqiperine dhe nisin betejen e re per dije e kulture, ngjitin shkalle me te larta ne tempullin e dijes, bejne me perpara ne plotesimin e endrres se tyre per t'u bere qytetare te denje te Atdheut te tyre te shtrenjte.

Prandaj edhe kete vit, 15 Shtatori, dita e pare e shkolles, eshte nje feste e vertete dhe shume e gezueshme per vogelushet qe shkelin per here te pare ne dyert e shkolles, per nxenesit qe kthehen nga pushimet verore, per mesuesit qe e presin kete dite si nje moment te vecante jo vetem festiv, por edhe si nje shans e mundesi per realizimin e misionit fisnik te tyre, eshte nje feste per prinderit dhe gjithe shoqerine.

Dita e pare eshte feste. Por qe kete dite fillon puna per te kurorezuar me rezultate te mira vitin e ri shkollor. Secili nga aktoret pjesemarres te ketij procesi, qe diten e pare nis punen per arritjen e objektivave dhe synimeve qe ka formezuar ne mendjet ose planet e tij. Shkolla eshte ne nje proces reformimi dhe te gjithe kane detyra per te zgjidhur dhe objektiva per te arritur.

Ne kete kuader kane objektivat e tyre edhe Sindikatat.

FSASH dhe SPASH, ne kete dite kaq te shenuar per arsimin kombetar, duke pershendetur sindikalistet anetare te tyre, mesuesit, nxenesit dhe prinderit dhe duke iu uruar suksese ne kete beteje te vertete per dije e kulture, ku ata jane angazhuar, parashtrojne para aktivit dhe anetareve te tyre objektivat kryesore sindikale qe sindikatat e arsimit synojne te arrijne gjate vitit te ri shkollor.

Ne fushen e objektivave **sociale ekonomike,** me perparesi do te trajtohen harmonizimi me i plote i sistemit te pagave midis kategorive te ndryshme te punonjesve te arsimit parauniversitar, mbeshtetur mbi kriteret e shkollimit dhe te diferencave midis pages minimale dhe maksimale; perpunimi dhe percaktimi i kritereve per dhenien e shperblimeve per motivim te mesuesve e sindikalisteve te dalluar, gjetjen dhe arritjen e zgjidhjeve ligjore per te mundesuar pensionin e parakoheshem per mesuesit qe kane mbi 35 vjet pune ne arsim, etj.

Ne fushen e objektivave **per angazhim efektiv te sindikatave per zhvillimin e thellimin e reformes ne arsim,** SPASH dhe FSASH do te vazhdojne te negocojne me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, per te hartuar kerkesa dhe standarde rigoroze bashkekohore per emrimin e drejtuesve te shkollave dhe te mesuesve, per t'i vene fre levizjes pa kriter dhe mbi baza antiligjore te tyre, me synimin e vetem qe ne arsim te punojne si mesues ata qe e meritojne dhe te drejtojne te aftet , te cilet duhet te mbrohen ligjerisht nga qendrimet subjektive, te njeaneshme, partiake dhe te frymezuara e nxitura nga interesa korruptive qe jane verejtur shpesh deri me sot. Ne kushtet kur Qeveria ka investuar dhe po investon per permiresimin dhe modernizimin e infrastruktures ne arsimin parauniversitar, kur pagat e mesuesve dhe ne pergjithesi motivimi i tyre eshte permiresuar e rritur ndjeshem, stabilizimi i emrimit dhe levizjes pa kriter te mesuesve dhe drejtuesve te shkollave, duke i prere rrugen punesimit ne arsim dhe ngritjes ne drejtim te te paafteve, **eshte kushti vendimtar qe percakton suksesin e reformes.**

Objektiv tjeter kryesor eshte edhe angazhimi i FSASH e SPASH per rritjen e kapaciteteve te tyre drejtuese, per zhvillimin e parneritetit social, sidomos ne nivelin e dyte midis Seksioneve Sindikale ne qarqe e rrethe dhe Drejtorive e Zyrave Arsimore, shumefishimi i pervojes dhe rezultateve qe kane sindikatat tona ne aksionin e madh per eliminimin e punes se femijeve, per kthimin ne shkolle te nxenesve qe e kane braktisur ate dhe per nxjerrjen nga rreziku te atyre qe jane kandidate per ta braktisur, forcimi i punes sindikale me komisionet e gruas e te rinise, etj.

PERMBAJTJA

Editorial

- Nga Takimi me Ministrin e Arsimit dhe Shkences 3
- Mesazh i përbashkët me rastin e Ditës Botërore të Mësuesve 3
- Qendrimi i sindikatave te arsimit mbi draftet per emrimin e drejtoreve dhe mesuesve ne shkollat publike 5
- Komente rreth dinamikes se pagave te mesuesve te sistemit parauniversitar 6
- Aktivitete ne zbatim te Projektit me FNV/AOb 8
- Kronike e nje dite te paharruar, *(Nga aktiviteti FSASH/SPASH/SBASHK)* 10
- Nga aktivitetet e FSASH dhe SPASH 11
- Perseri u shpalosen faqet e librave te diturise, nga Murat Gecaj 13
- Te reja shkencore dhe Keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Dita e pare e Vitit te Ri shkollor

Kopertina e fundit:
Nga aktivteteti i perbashket me sindikaliste te FSASH/SPASH/SBASHK

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 36
Shtator 2008
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA :
Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik,Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, Kryeredaktor

NGA TAKIMI ME MINISTRIN E ARSIMIT DHE SHKENCES

Me 17 shtator u zhvillua takimi midis Ministrit te ri te Arsimit dhe Shkences z. Fatos Beja dhe Kryetarit te FSASH z. Xhafer Dobrushi e Kryetarit te SPASH, z. Bajram Kruja. Ne takim ishte i pranishem edhe Zv/ Ministri i Arsimit e Shkences z. Halit Shamata.

Perfaqesuesit e Sindikatave uruan Ministrin per detyren e re dhe shprehen gatishmerine per te vazhduar, si deri me sot, partneritetin social me Ministrine e Arsimit dhe Shkences per mbrojtjen e kerkesave dhe interesave sociale ekonomike te mesuesve sindikaliste, nga njera ane, dhe per angazhimin e plote per reformimin dhe modernizimin e sistemit te arsimit parauniversitar, nga ana tjeter.

Ne takim te dy palet diskutuan per zhvillimin e metejshem te partneritetit social jo vetem ne nivel qendror, por vecanerisht ne nivel te dyte dhe evidentuan shqetesimet dhe problemet qe ekzitojne sot midis disa drejtorive e zyrave arsimore dhe seksioneve sindikale te te dy sindikatave ne qarqe e rrethe. Ministri mirekuptoi shqetesimet qe ngriten perfaqesuesit e sindikatave per disa shkelje konkrete dhe te renda te Kodit te Punes dhe Kontrates Kolektive nga ZA te Pogradecit, Devollit, Tepelenes, Pukes, etj, per levizjen nga vendet e punes te te zgjedhurve sindikale dhe dha porosi qe ato te analizohen e korrigjohen, ne pershtatje me zgjidhjet qe jep ligja dhe KK e Punes.

Vend i vecante iu kushtua vazhdimit te dialogut midis dy partnereve ne nivel qendror per te perfunduar harmonizimin e nenit 4, pika 4 te Kontrates Kolektive te Punes me udhezimin nr. 19 date 30.09.2006 per punesimin dhe largimin nga puna te mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike ose shkolla te tjera te mesme te profilizuara per mesuesi, me qellim qe te shmangen keqinterpretimet dhe abuzimet qe jane verejtur ne praktike nga DAR dhe ZA.

Perfundimi i draftit te Kodit te Etikes se Mesuesit dhe hartimi i normave ligjore qe mundesojne ngritjen e strukturave qe ngarkohen per zbatimin e tij, si dhe hartimi e miratimi i standardeve per emrimin dhe largimin nga puna te drejtoreve te shkollave dhe te mesuesve ishte nje angazhim i te dy partnereve, si kusht per te mundesuar zbatimin e nje aspekti te rendesishem te reformes ne arsimin parauniversitar.

Koresp. i " TRIBUNA SINDIKALE"

Mesazh i përbashkët me rastin e Ditës Botërore të Mësuesve 5 tetor 2008

Me datën 5 Tetor është Dita Botërore e Mësuesve, një ditë kur ne pranojmë rolin thelbësor që mësuesit luajnë për të bërë të mundur arsimim të përshtatshëm dhe ne nivelin e duhur për të gjithë fëmijët, të rinjte e të rriturit.

Megjithatë, në shumë vende, ka një mungesë të theksuar mësuesish, një shifër që vlerësohet të arrijë 2 milion vende pune dhe 18 milion mësuesish shtesë që nevojiten në të gjithë botën, nëse synohet të arrihet arsimim 9-vjeçar për të gjithë brenda vitit 2015. Për disa vende, kjo do të thotë një rritje në forcat e tyre arsimore deri në 280%. Një numër edhe më i madh mësuesish do të kërkohen nëse do të sigurohet një përgatitje e përshtatshme në arsimimin e mesëm, të lartë, teknik, profesional ose joformal. Këto shifra do të jenë më të larta, nëse të gjithë mësuesit do të duhet të jenë të kualifikuar tërësisht dhe në mënyrë të përshtatshme për nivelin dhe lëndët që ata japin. Edhe në rastet kur numri i përgjithshëm i mësuesve është i mjaftueshëm, zona të largëta dhe të pafavorizuara në të gjithë botën mund të kenë probleme të vazhdueshme gjatë rekrutimit, madje edhe gjatë periudhës së punës. Kjo mungesë mësuesish të kualifikuar është një ndër sfidat më të mëdha për të arritur qëllimin e Arsmimit për të Gjithë.

Profesioni i mësuesit përballet, gjithashtu, me sfidën e sigurimit të një arsimimi cilësor në lartësinë e kërkesave të reja të shekullit të 21-të. Nevojat ekonomike, sociale, shkencore dhe teknologjike, çështjet e zhvillimit të vazhdueshëm, ulja e nivelit të varfërisë dhe ceshtje të tjera që lidhen me to për të arritur punë të përshtatshme për të gjithë, epidemia e AIDS dhe dhuna në shkollë, po ndikojnë gjithnjë e më shumë në këtë profesion. Meqënëse femrat përbëjnë shumicën e forcës së punës në arsimin 9-vjeçar dhe shpesh preken në mënyrë disproporcionale nga këto çështje, ndikimi i mundshëm është i shumëllojshëm, prandaj barazia gjinore duhet të jetë kryesore në trajtimin e këtyre problemeve. Gjithashtu, progresi drejt Arsimimit për të Gjithë, dhe në veçanti arsimimi 9-vjeçar universal, po çon drejt një shumëllojshmërie nxënësish gjithnjë e më të madhe, që ndërlikon arsimimin dhe mësimdhënien.

Të gjendur përballë detyrimeve të tilla, kaq të larta, mësuesit shpesh ndihen të nënvlerësuar, të pa mbështetur sa duhet dhe të pakualifikuar profesionalisht për të përballuar realitetin e ambientit në të cilin ata punojnë. Më shumë rekrutime, trainim i plotë dhe i përshtatshëm i mësuesve, pagesa dhe shpërblime më të mira në krahasim me ato të profesioneve të tjera që kërkojnë kualifikime të ngjashme, kushte pune

Vijon në faqen 4

Mesazh i përbashkët me rastin e Ditës Botërore të Mësuesve 5 tetor 2008

Vijon nga faqja 3

dhe jetese më të mira, mbështetje profesionale të vazhdueshme dhe mundësi për rritje në karierë; të gjitha këto janë çështje thelbësore për të realizuar sfidat e reja.



Rekomandimet e ILO/UNESCO të vitit 1966, që lidhen me Statusin e Mësuesve dhe Rekomandimet e UNESCO të vitit 1997, që lidhen me Statusin e Personelit të Arsimit të Lartë, sigurojnë udhëheqje domethënëse për disa politika të drejta dhe përgjegjësi të mësuesve. Si të tilla, ato janë baza për praktika dhe politika kombëtare të së ardhmes, për të krijuar një forcë mësimdhënieje profesionale.

Politikat për mësuesit në nivel kombëtar duhet të jenë koherente me strukturat ekzistuese botërore dhe rajonale, për të ndihmuar që të sigurohet cilësi, për të identifikuar synimet, në mënyrë që të arrihet më shumë harmoni, meqënëse kemi një rritje të migrimit dhe lëvizshmërisë ndërkombëtare të mësuesve. Ato, gjithashtu, duhet të ndikojnë për të përmirësuar statusin dhe kushtet e punës të mësuesve. Ato duhet të përfshijnë edhe Planet për Uljen e Varfërisë dhe zhvillimin e politikave arsimore.

Është e rëndësishme që politikat në lidhje me mësuesit të vendosen me domosdoshmëri në kontekste lokale e kombëtare, të bazuara në prova dhe të jenë reale, në mënyrë që të lehtësojnë rekrutimin dhe mbajtjen në punë të një force mësmidhënieje të mjaftueshme në numër dhe efektive. Ato duhet të mbajnë parasysh konkluzionet e kërkimeve në të gjitha nivelet, si edhe aftësitë kombëtare, financiare e administrative dhe zhvillimin ekonomik.

Arritja e synimit të përcaktuar që në vitet '90 për të investuar 6% GDP në arsim do të ndihmonte në shumë sisteme kombëtare që nuk financohen mjaftueshëm. Hartimi i planeve dhe politikave duhet, gjithashtu, të jenë prioritare, të financohen mjaftueshëm dhe të jenë fleksibël, në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave gjithnjë në rritje. Për shembull, nëse modeli tradicional ku bazohet arsimi i lartë nuk është në gjendje të sigurojë një numër të mjafueshëm dhe në kohë mësuesish, përpjekjet moderne për trajnimin e mësuesve do të dështonin, pa arritur cilësi.

Përgjatë procesit të zhvillimit të politikave, është thelbësore të sigurohet që të arrihet dialog social midis aktorëve, duke përfshirë këtu autoritetet që bëjnë politikat, mësuesit, dhe organizatat e tyre. Dialogu social do të ndihmojë të ndërtohet konsensus kombëtar, drejt një zbatimi më të mirë të politikave në lidhje me mësuesit. Sic është shprehur edhe në Rekomandimet e ILO/UNESCO-s, shumë punë po bëhet për të arritur që aktorët kryesorë të marrin pjesë në realizimin e politikave në arsim, por kërkohet akoma më shumë krijim kapacitetesh.

Në Ditën Botërore të Mësuesve ne nderojmë mësuesit në të gjithë botën; në të gjitha vendet, qytetet dhe fshatrat. Ne, gjithashtu, theksojmë nevojën për të bërë të mundur që roli i mësuesve në arritjen e Arsimimit cilësisor për të Gjithë të reflektohet qartë në politikat që do të arsimojnë një forcë mësimdhënëse të motivuar, të çmuar dhe efektive.

Në këtë Ditë Botërore të Mësuesve ne falenderojmë mësuesit dhe pranojmë: "PO, MËSUESIT KANË SHUMë RËNDËSI".

Koichiro MATSUURA
Drejtor i Përgjithshëm
UNESCO

Juan SAMOVIA
Drejtor i Përgjithshëm
ILO

Kemal DERVIS
Administrator
UNDP

Ann M. VENEMAN
Drejtore Ekzekutive
UNICEF

Thulas NXESI
President
Federata Ndërkombëtare e Arsimit - EI

QENDRIMI I SINDIKATAVE TE ARSIMIT MBI DRAFTET PER EMRIMIN E DREJTOREVE DHE MESUESVE NE SHKOLLAT PUBLIKE

Kryesite e Sindikatave Qendrore te Arsimit, FSASH dhe SPASH, nenshkruese te Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare me Ministrin e Arsimit dhe Shkences, mbasi u njohen me variantin e drafteve per emerimin e drejtoreve te shkollave dhe te mesuesve, (te cilet jane botuar edhe ne gazeten " Mesuesi"), dhe pas konsultimeve me organet e tyre drejtuese, percaktuan qendrimin e tyre te perbashket per keto dy ceshtje thelbesore te reformes ne arsimin parauniversitar. Ky qendrim shprehet ne draftin qe po botojme, i cili reflekton mospajtimin e sindikatave me draftet qe kane pergatitur grupet e specialisteve ne nivel teknik te Ministrise Arsimit dhe Shkences. Drafti i botuar ne kete numer te Revistes " Tribuna Sindikale" perben bazen per diskutim midis dy partnereve ne nivel qendror per keto ceshtje.

Permbajtja e drafteve te propozuara nga FSASH e SPASSH per "Emerimet e drejtoreve te shkollave" dhe per "Emrimin e mesuesve ne shkollat publike" eshte:

Per Bordin e Arsimit:

Bordi i Arsimit ngrihet dhe funksionon ne nivel zone (rrethi) qe i korrespondon nje DAR ose ZA-je. Bordi i Arsimit perbehet nga: Drejtori i DAR ose ZA, nje perfaqesues i zgjedhur nga bashkite dhe komunat qe bejne pjese ne kete territor, kryetaret e Seksioneve Sindikale te FSASH e SPASH dhe nje perfaqesues i zgjedhur nga komuniteti i prinderve. Kryetar i Bordit eshte drejtori i Dar/Za.

Bordi i merr vendimet me shumicen e thjeshte te votave. Ne mbledhjen e Bordit ftohen sipas rastit specialiste nga DAR/ZA dhe nga bashkite ose komunat e interesuara per ceshtjet qe diskuton dhe vendos Bordi i Arsimit.

Per Emerimin dhe shkarkimin e Drejtorit te Shkolles:

Emrimi ne postin e drejtorit te shkolles publike behet mbi bazen e kritereve rigorozisht te percaktuara. Keto kritere hartohen nga MASH ne konsultim me sindikatat dhe aktore te tjere te interesuar nga shoqeria civile dhe behen pjese e Strategjise se Arsimit Parauniversitar.

Bordi i Shkolles. ne te cilin pervec perberjes qe ka sot, duhet te perfshihen edhe kryetaret e sindikatave qe funksionojne ne shkolle, administron aplikimet per postin e drejtorit te shkolles dhe zgjedh midis tyre dy kandidatura, te cilat ia propozon Bordit te Arsimit.

Bordi i Arsimit shqyrton dhe miraton njeren nga keto kandidatura. Nese Bordi nuk miraton asnjeren kandidature, Bordi i Shkolles duhet te perzgjedhe dhe te dergoje ne Bordin e Arsimit dy kandidatura te tjera.

Per Mandatin:

Kesaj procedure, e cila duhet te apliohet ne vitin shkollor 2008-2009, i nenshtrohen jo vetem drejtoret qe kane konsumuar nje mandat 4 vjecar, por edhe ata drejtore qe jane emeruar mbas dates 1 janar 2008.

Per zevendesdrejtoret e shkollave emrimi dhe shkarkimi behet nga Bordi i Shkolles duke zbatuar te njejtat kritere dhe te njejten procedure qe aplikohet per drejtoret e shkollave.

PER EMERIMIN E MESUESIT NE SHKOLLAT PUBLIKE :

Per " Kontraten ne mes te mesuesit dhe drejtorit te shkolles".

Mesuesit qe plotesojne kriteret e nenit 4 te Kontrates Kolektive te Punes, pra ata punonjes qe ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate jane konsideruar te punesuar definitive, me kusht qe te jene anetare te njeres nga sindikatat nenshkruese te Kontrates Kolektive te nivelit te pare, nuk kane detyrim per te nenshkruar asnje lloj kontrate tjeter as me drejtorin as me Bordin e Shkolles. As Bordi i Arsimit apo i Shkolles dhe as drejtori i shkolles, nuk mund t'u imponojne mesuesve te punesuar ne menyre definitive sipas nenit 4 te KK te Punes nenshkrimin e nje kontrate tjeter me ose pa afat kohor.

Detyrimet qe kane mesuesit per kualifikim te vazhdueshem, per zbatimin e rregullave te sjelljes e te paraqitjes, percaktohen ne Aktet Normative qe miraton Ministri i Arsimit dhe Shkences dhe ne Kodin e Etikes se Mesuesit, te cilet jane te harmonizuar me Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise, me Ligjin e Arsimit parauniversitar dhe me Kontraten Kolektive te Punes.

Per pjesen **" Shpallje e kerkeses per mesues"** :

Bordi i Shkolles shpall vendet e lira per mesues qe krijohen ne shkolle. Bordi shqyrton kerkesat e aplikanteve per vendin ose vendet e lira dhe shpall fituesit mbi bazen e kritereve qe percaktohen ne Aktet Normative dhe KK te Punes. Mesuesit e perzgjedhur per te punuar ne arsim, qe nuk plotesojne kushtet e nenit 4 te KK te Punes, pra nuk jane te punesuar ne menyre definitive dhe nuk jane anetare te nje sindikate nenshkruese te KK, i nenshtrohen procedures se kontraktimit individual.

Per vleresimin e punes se mesuesit:

Vleresimi i punes vjetore te mesuesit behet mbi bazen e treguesve te percaktuar nga MASH mbeshtetur ne Strategjine e Arsimit parauniversitar. Vleresimi duhet te pasqyroje vetem rezultatet e inspektimeve te specializuara profesionale dhe ato qe parashikohen ne Kodin e Etikes se Mesuesit. Vleresimi behet I hapur ne fund te vitit shkollor.

Per largimin e mesuesit nga puna:

Mesuesi mund te ndeshkohet me masa disiplinore ose te largohet nga puna vetem ne rastet qe percaktohen ne Kodin e Punes, ne Kontraten Kolektive te Punes dhe ne Aktet Normative te Ministrit te Arsimit dhe Shkences.

Masat disiplinore perfshire edhe largimin nga puna behen me propozim te drejtorit te shkolles dhe ven dosen nga Bordi i Shkolles. Mesuesi ka te drejten e ankimimit sipas kuadrit ligjor te marredhenieve te punes.

Qendrimi i Sindikatave te Arsimit per keto ceshtje eshte i mbeshtetur ne Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise, ne Kontraten Kolektive te Punes, ne Strategjine e Arsimit Parauniversitar, ne Aktet Normative, dhe, nga njera ane, garanton mesuesit e drejtuesit ne shkolle nga qendrimet subjektiviste, politike, hakmarresve dhe korruptive ne kurriz te tyre, ndersa nga ana tjeter, rrit kerkesen per profesionalizem e sjellje etike korrekte, per cilesi ne arsim dhe i jep hapesire punes se pavarur te mesuesit.

KOMENTE RRETH DINAMIKES SE PAGAVE TE SISTEMIT PARAUNIVERSITAR TE ARSIMIT

Periudha 2006 – 2008

Nga Xhafer Dobrushi, Kryetar i FSASH

Kerkesat per rritjen e pagave perbejne njerin nga funksionet me te rendesishme te cdo sindikate. Elementi "**paga"** dhe rritja e permiresimi i vazhdueshem i tyre formojne boshtin e kerkesave te fushes sociale ekonomike te sindikatave dhe sindikalisteve.

FSASH, qe nga themelimi i saj u eshte permbajtur ketyre parimeve sindikale, te cilat, te mbeshtetura ne Konventat Nderkombetare te Punes dhe ne legjislacionin shqiptar, kane gjetur pasqyrim ne Statutin e Federates. Ne perputhje me keto dokumente baze, FSASH, ne menyre te vazhdueshme, eshte vene me vendosmeri ne mbrojtje te kerkesave dhe interesave objektive dhe legjitime te sindikalisteve qe perfaqeson dhe te mases se punonjesve te arsimit, duke synuar per te arritur e garantuar nje page te denje per profesionin e mesuesit e te pedagogut ne perputhje me punen qe ata bejne dhe brenda mundesive qe ofron zhvillimi ekonomik i vendit ne etapa te caktuara.

Per te arritur kete qellim dhe keto objektiva te saj, FSASH ka kombinuar, sipas rrethanave dhe kushteve, levizjen sindikale me dialogun social. Jane te njohura levizjet e zhvilluara nepermjet manifestimeve dhe grevave njeoreshe, njeditore dhe njejavore. Jane te njohura dhe rezultatet qe jane arritur nepermjet ketyre levizjeve. Por, po kaq te sukseseshme kane qene edhe bisedimet e zhvilluara ne tavoline me punedhenesin, ku objektiviteti dhe bazueshmeria e kerkesave per rritjen dhe permiresimin e pagave brenda kategorive te ndryshme, kane gjetur mirekuptim dhe zgjidhje nga ana e punedhenesit dhe qeverise, zgjidhje qe jane kurorezuar me marreveshje konkrete, perfshire edhe Kontraten Kolektive te Punes.

Edhe si rezultat i kesaj lufte te vendosur e te vazhdueshme sindikale qe kane zhvilluar prej afro 10 vjetesh FSASH dhe SPASH se bashku, sot kemi nje sistem pagash ne arsimin parauniversitar pergjithesisht te konsoliduar dhe nje nivel pagash te pranueshem, te vleresuar pozitivisht nga sindikatat dhe mesuesit, krahasuar me mundesite qe ka vendi dhe ne raport me sektoret e tjere buxhetore.

Megjithe arritjet, rritja e pagave qe ka bere Qeveria e sotme qe doli nga zgjedhjet e vitit 2005, eshte bere dhe vazhdon te jete objekt diskutimesh jo vetem midis pozites dhe opozites, por edhe midis aktoreve te tjere te interesuar e lidhur me arsimin dhe arsimimin e brezit te ri, perfshire edhe sindikatat e sindikalistet.

Te ndodhur perpara ketij realiteti, per te shmangur keqkuptimet dhe keqinterpretimet, ne vendosem te botojme ne dy pasqyrat qe vijojne Dinamiken e rritjes se pagave te punonjesve te sistemit parauniversitar per periudhen 2006-2008, mbeshtetur ne vendimet perkatese te Keshillit te Ministrave.

Tabela 1
Dinamika e pagave te mesuesve te arsimit parauniversitar

Nr	Kategorite e mesuesve	Paga me 31. 12. 2005			Paga me 31. 12. 2005 me efektet e pages se 13te		Paga me 01. 07. 2008		Rritja ne perqindje pa pagen e 13-te		Rritja ne perqindje me pagen e 13-te	
1	Mesues ne shkollen e mesme		Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
		Min	21540	18872	23334	20444	39500	31126	83	65	69	52
		Max	28054	24366	30391	26396	47200	37194	68	53	55	41
		Mes	24890	21916	26963	23420	43350	34160	74	56	61	46
2	Mesues ne shkollen 9-vjecare	Min	19226	16939	20828	18350	36600	28841	90	70	76	57
		Max	25740	22414	27884	24281	44300	34908	72	56	59	44
		Mes	22576	19677	24456	21316	40450	31875	79	62	65	50
3	Mesues me arsim te mesem pedagogjik e profesional	Min	16600	14704	17983	15929	30000	23640	81	61	67	48
		Max	21710	19014	23518	20598	36300	28604	67	51	54	39
		Mes	19155	16859	21111	18263	33150	26122	73	55	57	43
4	Edukatore kopeshti	Min	16500	14619	17874	15837	34000	26792	106	83	90	69
		Max	23014	20114	24931	21789	41700	32860	81	63	67	51
		Mes	19850	17367	21504	18814	37850	29826	91	72	76	59
5	Mesatarja ne shkalle vendi	(1)	21618	18955	23509	20453	38700	30496	79	61	65	49
		(2)	22437	19653	24308	21183	40550	31954	81	63	67	51

Eshte e kuptueshme se cdo koment ose vleresim mund te jete i drejte, i panshem dhe real vetem nese mbeshtetet ne treguesit qe tashme kemi perpara.

Persa na perket ne si sindikata, para se te kalojme ne analizen dhe komentet mbi pasqyrat qe po botojme, duam te theksojme se premtimi i Qeverise dhe Kryeministrit Berisha, i bere jo vetem gjate fushates elektorale, por edhe ne takimin e muajit tetor 2005 me drejtuesit

kryesor te sindikatave te arsimit per dyfishimin e pagave te mesuesve te sistemit parauniversitar brenda periudhes 2006-2009, eshte mirepritur nga mesuesit, sindikatat dhe sindikalistet. Jashte pozicioneve dhe kompleksеve politike te dites dhe atyre elektorale, kjo nisme eshte pershendetur, sidomos nga ata qe perfitojne prej saj.

Po cfar tregon realiteti pas tri vjetesh nga ky premtim? Per te komentuar e vleresuar kete ne po perqendrohemi ne disa momente kryesore qe permbajne treguesit qe kemi perpara.

Se pari, po te vrojtojme dhe krahasojme rritjen e pagave ne keta tre vjet per mesuesit me arsim te larte qe jane te punesuar ne shkollat e mesme, 9 vjecare ose ne kopshte, (shih pasqyren nr. 1, renditja 5 (2), rezulton se si mesatare ne shkalle vendi pagat e tyre, krahasuar me vitin 2005, jane rritur 67 perqind bruto dhe 51 perqind neto. Nese perfshijme ne keto kategori punonjesish edhe mesuesit me shkolle te mesme pedagogjike ose shkolla te tjera te mesme profesionale, (shih pasqyren nr. 1, renditja 5 (1), rezulton se rritja eshte 65 perqind per pagat bruto dhe rreth 44 perqind per pagat neto.

Qeveria pretendon se pagat e mesuesve te sistemit parauniversitar ne keta tre vjet jane rritur 75 perqind.

Pse eshte kjo mosperputhje midis shifrave qe u referohet Qeveria dhe shifrave qe u referohen sindikatat?

Mosperputhja vjen nga fakti se Qeveria, kur flet per rritjen e pagave, bazohet vetem mbi nje tregues, vetem mbi **pagen bruto,** ndersa sindikatat, kur dialogojne per rritjen e pagave, mbajne parasysh te dy treguesit, pra si pagen bruto, ashtu edhe ate neto dhe lidhjen qe ekziston midis tyre. Per periudhen per te cilen diskutojme, vertete paga bruto eshte rritur ndjeshem, pra mesatarisht 65-67 perqind ne shkalle vendi, dhe ne disa kategori sic jane mesuesit e rinj ne shkollat e mesme dhe 9 vjecare si dhe edukatoret e kopshteve, deri ne 69 ose edhe 76 perqind, paga neto nominale eshte cenuar, gjithashtu, ndjeshem nga aplikimi i takses se sheshte, pa permendur ketu vleren e saj reale qe kercenohet nga rritja e cmimeve dhe inflacioni. Kjo eshte aresyeja qe sindikatat, ndersa pranojne dhe dialogojne per rritjen e pagave duke u nisur fillimisht nga paga bruto, mbajne parasysh dhe mbrojne me vendosmeri si tregues jetik pagen neto.

Mosperputhja vjen, gjithashtu, edhe per nje shkak tjeter. Ndersa Qeveria e krahason rritjen e pagave, si bruto ashtu edhe neto, me pagen mujore te vitit 2005 pa efektet e pages se 13-te, sindikatat rritjen e pagave ne vitet 2006-2008 e krahasojne me pagen mujore te vitit 2005 **perfshire efektet e pages se 13-te,** sepse kjo eshte e verteta, sepse deri ne vitin 2005 mesuesit me ligj dhe me VKM merrnin 13 paga ne vit e jo 12, sic eshte sot dhe krahasimi qe behet me 12 paga rrit artificialisht pagen e mesuesve me 8.3 perqind ne muaj. Pra kjo rritje ekzistonte, nuk eshte merite e Qeverise. Kete e dijne jo vetem sindikatat, por te gjithe mesuesit.

Se dyti, Sindikatat e Arsimit tabllone e sotme reale te rritjes se pagave ne sistemin e arsimit parauniversitar e shikojne dhe vleresojne me realizem. Pavaresisht nga kendveshtrimi i ndryshem i te njejtave shifra nga Qeveria dhe Sindikatat, qe paraqitem me lart, rritja e pagave ne arsimin parauniversitar ne periudhen 2006-2008, keshtu sic eshte, perben nje hap shume serioz dhe te pakrahasueshem me vitet e mepareshme te cdo qeverisje te periudhes se tranzicionit per vleresimin e punes dhe te figures se mesuesit, rritje qe ka ndikimin e vet te padiskutueshem ne pergatitjen e kushteve per suksesin e reformes ne arsim.

Por sindikatat nuk do te ndalen ketu. Ashtu sic na eshte premtuar, ne do te insistojme ne dialogimet qe do te zhvillohen ne javet dhe muajt e ardhshem, qe ne vitin 2009 pagat e mesuesve te arsimit parauniversitar te rriten mesatarisht jo me pak se 20 perqind. Ne nuk do te heqim dore nga kjo kerkese. Kjo do te bente qe ne kater vjetet e kesaj qeverisjeje paga bruto vertete do te dyfishohej dhe paga neto do te permiresohej ndjeshem. Brenda kesaj rritjeje, Sindikatat ne bashkepunim me MASH do te kene mundesi te kryejne disa permiresime sic jane raportert midis pages minale e maksimale, mbi nivelin e shkollimit, kualifimin e mesuesve, etj.

Tabela 2

Rritja e pagave te mesuesve te arsimit parauniversitar ne vitin 2008 ne raport me vitin 2007

Nr	Kategorite e mesuesve	Paga me 01. 07. 2007 VKM Nr.440, dt. 13.07.07			Paga me 01. 07. 2008 VKM Nr. 1095 dt. 02. 07. 08		Rritja ne shume absolute		Rritja en perqindje		Numri i punonjesve
1	Mesues ne shkollen e mesme		Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	7464
		Min	35800	28210	39500	31126	3700	2916	10.3	10.3	
		Max	42835	33754	47200	37194	4365	3440	10.2	10.2	
		Mes	39318	30982	43350	34610	4033	3178	10.2	10.2	
2	Mesues ne shkollen 9-vjecare	Min	31610	24909	36600	28841	4990	3932	15.8	15.8	20023
		Max	38645	30452	44300	34908	5655	4456	14.6	14.6	
		Mes	35128	27681	40450	31875	5322	4194	15.1	15.1	
3	Mesues me arsim te mesem pedagogjik e profesional	Min	26550	20921	30000	23640	3450	2719	13	13	4000
		Max	32815	25858	36300	28604	3485	2746	10.6	10.6	
		Mes	29683	23390	33150	26122	3468	2733	11.7	11.7	
4	Edukatore kopeshti	Min	25950	20449	34000	26792	8050	6343	31	31	3639
		Max	32985	25992	41700	32860	8715	6868	26.4	26.4	
		Mes	29468	23221	37850	29826	8382	6605	28.4	28.4	

Aktivitete ne zbatim te Projektit me FNV/AOb

Seminar per eliminimin e punes se femijeve me perfaqesues te shkollave pilot ne rrethin e Tiranes.

Ne vijim te aktiviteteve ne kuadrin e zbatimit te Projektit me sindikatat holandeze, FNV/AOb, ne Kamze u organizua keto dite seminari per angazhimin e mesuesve dhe te sindikatave te arsimit per eliminimin e punes se femijeve, me pjesemarrjen e anteareve te grupeve te punes qe veprojne ne shkalle zone dhe ne kater shkollat pilot, Kamez e re, Valias, Zallmner dhe Bulqesh.



Ne seminar moren pjese 32 pjesemarres, perfshire edhe drejtoret e ketyre shkollave, nxenes e mesues aktive ne punen per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve, drejtuesit e seksioneve perkatese te FSASH/SPASH per rajonin e Tiranes, kretaret e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja etj.

Ne kete seminar u realizua nje gershetim efektiv i pjeses teorike mbi standardet nderkombetare dhe legjislacionin shqiptar per mbrojtjen e femijeve, paraqitur nga Zonja Shkelqesa Manaj, drejtuese e Njesise per Eliminimin e Punes se Femijeve qe vepron prane Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, me analizen e punes se bere dhe te detyrave qe dalin ne vijim per eliminimin e punes se femijeve.

Pjesa me rendesishme e seminarit ishte diskutimi konkret ne lidhje me punen e bere, situaten aktuale ne shkollat respektive, bazuar ne pyetesoret e plotesuar gjate vitit te kaluar, dhe drejtimet kryesore te punes ne vijim.

Ne fillim, Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi, foli mbi punen qe po bejne dy sindikatat tona te arsimit ne nivel kombetar dhe ne 6 rrethet e perzgjedhura per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe per eliminimin e punes se femijeve. Ai vleresoi punen e mbi 1 500 mesueseve te cilet jane te angazhuar drejtperdrejt ne aktivitetet dhe punen konkrete, duke kthyer ne shkolle ose nxjerre nga rreziku i braktisjes se shkolles me shume se2 400 nxenes, gje qe eshte nje shembull per te gjithe masen e gjere te mesuesve ne keto rrethe, por edhe ne shkalle vendi.

Duke folur ne emer te grupit te punes te shkolles se Valiasit, mesuesja Lindita Diko, vuri ne dukje se objekt i nje pune te vecante individuale te grupit te punes, mesuesve dhe administrates se shkolles jane mbi 51 nxenes, 36 prej te cileve vajza, qe kane braktisur shkollen dhe detyrohen te punojne, per shkak te situates se veshtire familjare ose per aresyye te tjera. Me tej, ajo u ndale tek format e punes qe jane perdorur per kthimin e nxenesve ne shkolle, duke permedur me theks te vecante perfshirjen e vete nxenesve ne grupet e punes dhe ne aktivitetet e tjera te organizuara, perfshire edhe takimet me prinderit e tyre.

Mesuesi i shkolles se Kamzes se Re, Mersin Terpo, theksoi se objekt i punes se anetareve te grupit, mesuesve dhe administrates se shkolles jane mbi 54 nxenes, 28 prej te cileve jane vajza, te cilet pothuaj se te gjithe punojne duke shitur ne rruge, ose ne pune te tjera perfshire edhe punet e veshtira e te rrezikeshme ne ndertim. Ai theksoi, gjithashtu, se ka edhe disa nxenes te tjere qe jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, per aresye se ata punojne para ose pas mesimit dhe ne shume raste detyrohen te mungojne ne mesim, gje qe eshte hapi i pare drejt braktisjes se shkolles. Puna e vecante me keta nxenes u theksua ne seminar eshe, gjithashtu, shume e rendesishme, sepse eshte nje mase e rendesishme parandaluese.

Duke folur per rolin e vecante te vete nxenesve ne punen per uljen e numrit te nxenesve qe braksisin shkollen, nxenesja Valbona Mujo foli per nje rast kur nje shok i klases braktisi shkollen per aresye ekonomike. Vajza tregoi se ne takimin me prinderit, ne fillim ata nuk treguan te verteten, duke nxjerre shkaqe te ndryshme, si “nuk e ka qeif shkollen”, “nuk e perfillin shoket e klases” etj, por, mbas insistimit te

bashkemoshatareve dhe mesuesit kujdestar, mamaja e djalit tregoi te verteten per gjendjen e familjes dhe aresyet ekonomike qe nuk e lejonin te dergonin djalin ne shkolle. E vetmja zgjidhje eshte grumbullimi i disa kontributeve per kete familje, gje qe nxenesit jane duke e bere, me qellim qe shoku i klases te kthehet ne shkolle.

Ne emer te grupit te punes dhe mesuesve te shkolles Bulqesh foli zoti Kujtim Daka, i cili theksoi se mesues e nxenes te kesaj shkolle jane duke punuar me rreth 56 nxenes, prej te cileve 34 vajza, te cilet kane braktisur shkollen. Ai permendi shkaqet kryesore te kesaj situate, duke vene ne plan te pare ato ekonomike, por duke mos perjashtuar edhe ato qe kane te bejne me mentalitetin, sidomos kur eshte rasti i vajzave te klasave te larta, ose pamundesia per te perballuar kerkesat e shkolles per unifomen, sic eshte rasti i nxenesit Ardian Hoxha, per te cilin shoket e klases, nepermjet kontributeve modeste, ndihmuan konkretisht, duke e larguar nga puna ne rruge dhe duke e kthyer ne shkolle. Rezultatet e kesaj pune jane te dukeshme dhe ato maten me numrin e nxenesve te kthyer ne shkolle, te cilet vetem gjate ketyre diteve te para te shkolles, jane kater te tille.

Drejtuesi i grupit te punes te shkolles Zallmner, mesuesi Ilir Taga, evidentoi situaten ne shkollen e vete dhe punen qe eshte bere e po behet per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen, duke theksuar se jane 38 te tille ne kete shkolle, prej te cileve 21 jane vajza. Ai theksoi se, krahas shkaqeve ekonomike, nuk mungojne edhe aresyet qe lidhen me mentalitetin e prinderve, me te cilet ne jemi duke punuar me forma nga me te ndryshmet, duke organizuar grupe me mesues e nxenes, e sidomos me nxenese vajza, te cila marrin persiper pergjegjesine perpara prinderve te ketyre vajzave per t'u kujdesur e shoqeruar ato gjate kohes qe jane ne shkolle.

Drejtuesit e shkollave vleresuan angazhimin e sindikatave ne punen per shmangien e largimeve nga shkolla dhe premtuan bashkepunim te drejtperdrejte, duke punar se bashku ne kete front te rendesishem te permiresimit te situates ne keto shkolla, duke u bere nje shembull i mire edhe per shkollat e tjera te zones e me gjere.

Me nderhyrjet dhe sqarimet e veta, drejtuesit kryesore te FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, kontribuan drejtperdrejt ne rritjen e efektivitetit te ketij seminari dhe percaktimin e detyrave konkrete per te ardhmen.

Domosdoshmeria e perfshirjes se sa me shume mesuesve ne punen parandaluese, duke u marre konkretisht dhe ne menyre individuale me nxenesit ne rrezik per ta braktisur ate, ishte konkluzioni kryesor qe doli nga ky seminar.

Mbledhje me drejtuesit lokale te seksioneve ne proces konsolidimi

Nje mbledhje e rendesishme u organizua, githashtu, me drejtuesit lokale te seksioneve ne konsolidim e siper nga disa rrethe te vendit. Perfaqesues te SPASH e FSASH, pjesemarres ne kete mbledhje, informuan mbi situaten ne lidhje me krijimin dhe konsolidimin e strukturave, anetaresine me kuotizacion, dhe problemet me te cilat ata ndeshen ne mardheniet e punes.

Per rezultate te mira dhe ne keto drejtime folen sidomos drejtuesit e seksioneve te Bulqizes, Kurbinit, Pukes e Tropojes, nderkohe qe akoma vahdojme te kemi probleme ne Lushnje e Delvine per FSASH, Sarande e Has per SPASH.

Te pranishem ne kete mbledhje, kryetaret e FSASH, Xhafer Dobrushi dhe SPASH, Bajram Kruja, kerkuan me shume veprime konkrete, duke perfshire ne to gjithnje e me shume mesues anetare te te dy sindikatave, dhe insistuan ne riorganizimin e strukturave efektive te seksioneve perkatese ne rrethe.

Sipas detyrave te percaktuara ne kete mbledhje, kryesite qendrore te te dy sindikatave po organizojne punen ne disa rrethe, si Gramsh, Berat, etj, duke riorganizuar strukturat dhe duke ndihmuar seksionet per terheqjen e sa me shume mesuesve ne radhet e sindikatave.

Takime me anetaret e grupeve te punes ne rrethe e shkolla, per eliminimin e punes se femijeve

Ulja e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe i drejtohen punes, tani qe viti i ri shkollor sapo ka filluar, ishte objekt i takimeve qe FSASH e SPASH kane organizuar keto dite ne rrethet Fier, Tirane (zona e Kamzes) dhe Durres.

Ne Fier e Tirane, keto takime u organizuan ne nje salla te perbashketa, duke u mbledhur e diskutuar se bashku te gjithe anetaret e grupeve, me synim qe te perfitohej nga pervoja e njeri-tjetrit dhe te nxirreshin disa konkluzione te perbashketa per punen ne te ardhmen. Ishte e rendesishme qe keto takime u organizuan menjehere sapo filloi viti i ri shkollor, gje qe ka ndikuar drejtperdrejt ne evidentimin e problemeve qe kane te bejne me rregjistrimin e te gjithe nxenesve ne shkolle, vijimin e rregullt dhe probleme te tjera qe lidhen me mbarevajtjen e ketij viti shkollor.

Diskutimet ishin vertete konkrete, duke folur secili per nxenes me emra e probleme konkrete, per punen e bere dhe ate qe pritet te behet ne ditet e javet ne vijim, per arritjet e pengesat, metodat e punes qe jane perdorur etj.

Perfaqesues te drejtorive arsimore dhe drejtues te shkollave qe moren pjese ne keto takime, vleresuan punen e sindikatave te arsimit dhe te mesuesve te angazhuar ne keto aktivitete, duke siguruar ne te njejten kohe edhe vazhdimin e angazhimit te drejtorive te shkollave, duke punuar ne nje front te perbashket per te bere permiresime te dukeshme ne kete drejtim.


Te dy kryetaret e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, te cilet moren pjese aktive ne keto takime, u njohen me punen e bere, si edhe problemet me te cilat ndeshen mesuesit dhe drejtuesit e sindikatave, ne keto shkolla, per te cilat eshte informuar edhe Ministria e Arsimit dhe po kordinohet puna per zgjidhjen e tyre.

Stavri Liko

Kronike e nje dite te paharruar

Nga aktiviteti i perbashket i FSASH, SPASH dhe SBASHK

Nje dite e paharruar, keshtu e quajtem sepse ishte e para here qe perfaqesus te sindikatave te arsimit te Kosoves dhe te Shqiperise, (tingellon disi e çuditshme kur i ndajme Kosove dhe Shqiperi), u takuan ne Durres. Dikush kishte arritur me heret dhe priste te tjeret. Sigurisht s'ishte nje takim i zakonshem ku mblidhemi te diskutojme problemet tona, por diçka me shume. E rendesishme ishte se ne ishim bashke. Disa nga ne njiheshim dhe me pare, por ajo dite ishte me solemne. Shtrenhu vellezerit tane nga Kosova me veprimtarine sindikaliste, por mundesoi nje bashkebisedim konkret. Kryetari i Sindikates se Mesuesve Kosovare, Ali Shabani solli pershendetjet e mesuesve kosovare, i njohu pjesemarresit me vishtiresite e kohes, te cilat do te kalohen me sukses tashme ne Kosoven e lire. Ai falenderoi mesuesit dhe gjithe popullin per ndihmen e pakursyer qe u kane dhene vellezerve te tyre kosovare, si ne luften per liri, gjithashtu, edhe ne punen per forcimin e arsimit kombetar



gonim duart me njeri-tjetrin duke kaluar veshtiresite e para. U miqesuam menjehere dhe shume shpejt filluan bisedat here njohese e here sindikaliste. Urimet me shume ishin ne gojen e mikepritesve. Uronim per Kosoven martire qe tashme eshte e lire. Uronim edhe sindikatat per punen e tyre. Nje kafe para fillimit te aktivitetit beri qe, kur hyme brenda ne salle, te ndjeheshim mire. Aktiviteti i menduar si shkembim eksperience, krijoi nje mjedis sa pune aq dhe argetimi, sa njohjeje aq dhe bashkepunimi.

Hapjen dhe njohjen me veprimtarine e sindikatave e beri Xhafer Dobrushi, kryetar i FSASH-it, i cili jo vetem i njodhe bashkepunimin sindikalist ne ndihme te forcimit te te dy sindikatave. Prof. Xhafer Xhaferi njohu pjesemarresit me Statutin e sindikates se mesuesve kosovare, SBASHK, rreth te cilit pati pyetje dhe shkembim idesh. Me tej aktiviteti vazhdoi me disa foto miqesore te shoqeruara me diçitura, te cilat i lane vendin nje rezymeje te zhvillimit sindikalist te mesuesve shqiptare nga viti 1992.

U njohem me kontratat kolektive te te dy paleve, gje qe beri te shtrohen pyetje dhe te jepen pergjigje nga drejtuesit sindikalsite Zenel Zeneli dhe Defrim Spahiu. Ne kete pike pati edhe shume diskutime.

Paraqitja e fotove te perbashketa ndertoi biseda ku u evidentuan shume probleme, vishtiresi dhe vuajtje te popullit kosovar ne luften e tij per liri. Zoti Bajram Kruja, Kryetar i SPASH-it, evidentoi probleme qe kane te bejne me unifikimin e veprimtarise arsimore e pedagogjike, unifikimin e veprimtarise sindikaliste e cila duhet te ndertohet ne marredheniet e ndersjellta, ne realizimin e veprimtarive te perbashketa. Kjo gje hapi biseda te lira ku pjesemarresit e konsideruan te domosdoshme kete bashkepunim si ne lidhjet ndermjet dy qeverive, por veçanerisht ne bashkepunimin sindikalist, te cilet mund dhe duhet ta unifikojne veprimtarine e tyre ne disa drejtime.

Ne kohen e lire vazhduan njohjet, diskutimet, u bene foto te perbashketa, u shkembyen adresa e-maili, numra telefoni e celularesh. Secili nga ne i shihte mesuesit nga Kosova si luftetare te lirise dhe pioniere per zhvillimin e arsimit kombetar shqiptar.

Te shoqeruar nga Zv. Ministri i Arsimit prof. Agim Hyseni, i cili ka qene me pare kryetar i kesaj sindikate, bisedat moren karakter problemor. Ato u shoqeruan me besimin e madh te mesuesve tek e ardhmja e Kosoves, tek e ardhmja e arsimit shqiptar, me besimin se mesuesit do te kene nje jete me te mire.

Darka e menduar si nje aktivitet i perbashket kaloi ne menyre te mrekullueshme. Vallet popullore dhe kenga e shoqeruan ate. Vallezuam dhe kenduam se bashku. Te gjithe e ndjene veten te çliruar. Tashme ishim nje. Ata qe deri dje ishin luftetare te lirise, pjesetare te greves, sot po hidhnin vallen e bukur te lirise, vallen e bukur shqiptare me endrren qe te jemi nje shtet, nje sindikate.

Keshtu u mbyll nje dite e mrekullueshme. Kjo do te mbahet mend. Ne me siguri do te kemi edhe takime te tjera, por kjo do te mbetet e paharruar.

Aleks DUSHI

Aktivitete te FSASH

Gjate muajit shtator, Kryesia e FSASH ka organizuar disa aktivitete te rendesishme per permiresimin e punes ne disa seksione dhe per riorganizimin e seksioneve sindikale ne disa rrethe.

Takim me drejtues lokale ne Shkoder

Me shume se 20 kryetare te keshillave sindikale, kryesisht nga shkollat e komunave dhe fshatrave, moren pjese ne kete takim. Kryetari i seksionit sindikal te rrethit, zoti Isa Reka, beri nje prezantim te punes se bere rezultateve te arritura dhe problemeve me te cilat ballafaqohen seksioni dhe keshillat sindikale te shkollave ne kete rreth.

Thelbi i prezantimit te tij ishte: pune eshte bere dhe eshte duke u bere, disa rezultate jane arritur, por situata mund te konsiderohet akoma e pakenaqeshme dhe shume pune duhet te behet nga secili prej drejtuesve te keshillave sindikale te shkollave, si edhe nga seksioni sindikal ne shkalle rrethi. Ai vuri ne dukje, gjithashtu, disa probleme te cilat i ngrene me shqetesim perfaqesuesit e sindikatave ne shkolla dhe vete mesuesit, qe kane te bejne siodomos me nivelin e pagave, kualifikimin profesional, levizjet pa kritere te mesuesve, shperblimet per vjetersine, pagesat per vizitat mjekesore dhe kontrollin e detyrueshem shendetesor etj.

Pjesemarresit qe e moren fjalen, midis te cileve, Ruzhdi Kola, Petrit Çela, Kujtim Shima, Laze Kodra, Vat Demaj, Kole Çardaku etj, krahas paraqitjes se gjendjes ne lidhje me funksionimin e sindikatave ne shkollat perkatese, folen mbi probleme te vecanta qe kane ngritur mesuesit, duke kerkuar me shume mbeshtetje nga seksioni sindikal ne shkalle rrethi dhe nga vete Federata ne nivel qendror.

Kryetari i Keshillit Sindikal te Konnfederates per rrethin e Shkodres, zoti Fatmir Smajli, theksoi nevojen per nje pune te bashkerenduar, sidomos ne disa shkolla te qytetit dhe ne disa zona te tjera te rrethit, per te cilat ai premtoi nje angazhim me rezultativ edhe te keshillit sindikal te rrethit dhe te vete seksionit sindikal te arsimit ne kete rreth.

Duke e mare fjalen ne kete takim, Kryetari i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, zoti Xhafer Dobrushi, vleresoi punen e bere, por ate e konsideroi si nje fillim te mire te nje riorganizimi te pergjithshem te ketij seksioni, duke kerkuar per kete nje angazhim me effektiv edhe nga seksioni dhe nga vet keshillat sindikale ne shkolla.

Ne vijim, ai beri sqarimet perkatese ne lidhje me rritjen e pagave dhe kerkesat e FSASH-it, per permiresime te metejshme ne kete drejtim, rolin e sindikatave per shmangien e levizjeve pa kritere te mesuesve dhe sidomos per denoncimin e levizjeve me baze bindjet politike ose interesa te tjera, permiresimin e sistemit te transportit te mesuesve, qendrimin e sindikateve ne lidhje me Kodin e Etikes per mesuesit, perpjekjet e tyre per te bere te mundur pagesen nga ana e shtetit te shumes per kontrollin e detyrueshem mjekesor per te gjithe mesuesit anetare te FSASH e SPASH, pjesemarrjen e tyre efektive ne procesin e reformave ne sistemin arsimor, angazhimin e sindikatave per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve etj.

Pas diskutimeve konstruktive dhe konkluzioneve perkatese, ne takim u percaktuan detyra konkrete per keshillat sindikale te shkollave pjesemarrese dhe per seksionin sindikal te rrethit.

Takim me kryetare te sindikatave te shkollave te Tiranes

Drejtuesit e keshillave sindikale te me shume se 35 shkollave te qytetit te Tiranes u mblodhen ne prag te fillimit te vitit te ri shkollor, per te diskutuar ne lidhje me detyrat qe u dalin sindikatave per mbarevajtjen e procesit mesimor dhe mbrojtjen e interesave social ekonomike te mesuesve.

Kryetarja e seksionit, zonja Fatbardha Keço, paraqiti, ne menyre te permbledhur, drejtimet me kryesore te punes se seksionit dhe te sindikatave ne shkolla, duke e vene theksin tek sqarimi i mesuesve per domosdoshmerine e anetaresimit ne sindikate, por edhe tek roli i keshillave sindikale ne shkolla per te njohur nga afer dhe per te zgjidhur ose informuar seksionin per problemet qe u dalin mesuesve, sidomos ne lidhje me mardheniet e punes ne shkolle.

Ne fjalen e vete ne kete takim Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi, vleresoi punen e bere nga seksioni sindikal i qytetit te Tiranes dhe keshillat sindikale te shkollave pjesemarrese, sqaroi disa nga angazhimet kryesore te Kryesise dhe Keshillit Drejtues te Federates, mbeshtetur sidomos tek disa kerkesa e probleme qe kane ngritur mesuesit anetare te sindikatave te arsimit dhe kerkoi nje pune me efektive dhe nje bashkepunim me te mire te keshillave sindikale me administraten e shkollave, si parakushte per mbarevajtjen e procesit mesimor, forcimin e metejshem te sindikatave dhe mbrojtjen gjithnje e me te mire te mesuesve anetare te FSASH-it.

Rioganizimi i seksionit sindikal te rrethit te Gramshit

Ne qytetin e Gramshit u mblodh aktivi i Seksionit Sindikal te FSASH. Ne kete takim z. Pozaet Qose i beri nje analize punes se Seksionit dhe evidentoi dobesite qe jane verejtur ne

Vijon në faqen 11

Vijon nga faqja 11

punen drejtuese ne organizimin e seksionit dhe funksionimin e keshillave sindikale ne shkolla.

Te pranishmit ne takim, duke sjelle mendimin e sindikalisteve te ketij rrethi qe aderojne ne FSASH, theksuan se jane te gjitha mundesite qe keshillat sindikale ne shkolla dhe seksioni i Federates per rrethin te funksionojne ne menyre statutore, te marrin pergjegjesi para mases sindikaliste qe i ka zgjedhur dhe te realizojne mbrojtjen sociale ekonomike te tyre.

Ne takim u ngriten disa shqetsime qe lidhen me moszbatimin nga ZA e Gramshit te Kontrates Kolektive te Punes dhe me dialogun qe duhet te zhvillohet ne kete nivel per te mbeshtetur zbatimin e drejte te reformes ne arsim.

Per dobesite qe jane verejtur ne punen drejtuese te ketij seksioni, z. Pozaet Qose paraqiti doreheqjen. Ne menyre unanime, aktivi zgjodhi kryetar te Seksionit Sindikal te FSASH per Gramshin, mesuesin Albert Cace.

Ne takim mori pjese dhe foli edhe kryetari i FSASH, z. Xhafer Dobrushi.

Riorganizimi i seksionit Sindikal te rrethit te Beratit

Pas nje pune pergatitore te nje grupi mesuesish simpatizante te FSASH, te mbeshtetur e organizuar edhe nga i derguari i KSSH-se ne rrethin e Beratit, zoti Hajdar Kanani, para pak diteve u mblodh ne Berat aktivi i FSASH-it per kete rreth ku u riorganizua edhe seksioni sindikal i FSASH-it.

Ne fillim disa nga pjesemarresit informuan per punen pergatitore qe ata kishin bere, per problemet me te cilat ata ndeshen dhe per zgjidhjen e te cilave kerkojne mbeshtetjen e sindikates.

Pas sqarimeve te bera nga Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi, sidomos ne lidhje me domosdoshmerin e organizimit ne sindikate, rolin e seksionit sindikal ne shkalle rrethi dhe ate te Federates ne nivel kombetar, angazhimin e vete mesuesve ne strukturat perkatese dhe disa nga zgjidhjet e koheve te fundit te dy sindikatave te arsimit, nepermjet kontrates kolektive dhe formave te tjera te bashkepunimit me Ministrine e Arsimit dhe organet e tjera, u bene zgjdhjet per Kryesine e Seksionit Sindikal te rrethit, kryetar i te cilit u zgjodh mesuesi Adriatik Hasanbasha. Ne Kryesi u zgjodhen, gjithashtu, edhe Eriketa Zeqa (Zv/Kryetare), Irfan Myftari, Besmir Hori dhe Pajtim Qato.

Ne nje mbledhje te menjehershme, Kryesia percaktoi prioritetet kryesore te punes se saj per ditet dhe javet ne vijim, duke synuar zgjerimin e anetaresise ne shkollat pjesemarrese, zgjerimin e shtrirjes ne shumicen e shkollave te Beratit dhe konsolidimin e metejshem te seksionit sindikal ne shkalle rrethi.



Nga aktivitetet e SPASH

Mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH

Me 13 shtator te ketij viti u mbajt mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH, ku moren pjese drejtuesit e seksioneve sindikale, anetare te Keshillit Kombetar.

Duke falenderuar per pjesemarrjen ne aktivitetin ne SBASHK e Kosoves dhe FSASH te dates 12.09.2009, Z.Bajram Kruja ia dha fjalen dy drejtuesve me shume eksperience ne forumet sindikale, Z.Aleks Dushi per problemet e Statutit dhe Z.Defrim Spahiu per problemet e Kontrates Kolektive.

Z.Aleks ne fjalen e tij tha se Statuti per nje organizate sindikale eshte si Kushtetuta per nje shtet. Shpesh ne jemi te pavemendshem, kur marrim pjese ne grupe pune, ne seminare dhe deri ne kongrese qe jane vendimmarrese per statutet si dhe per ndryshimet qe koha i kerkon.

Qe te funksionoje mire nje organizate me nenet e Statutit, duhet te jene paraqitur qarte dhe shume sakte veprimtaria dhe vendimmarrja e organeve drejtuese, ekzekutive, verifikuese, sic jane: Kongresi, Keshilli Kombetar, Komiteti Ekzekutiv, Presidenti, Komisioni i zgjidhjes se konflikteve dhe i mandateve, Komisioni i Kontrollit ekonomik dhe financiar etj.

Te gjitha keto zgjidhen ne Kongres, ne menyre demokratike, per te

Vijon në faqen 13

Vijon nga faqja 12

funksionuar demokratikisht. Ndersa sherbimet qe u ofrohen anetareve jane paraqitur ne kontraten kolektive te punes, ne nivel te pare dhe te dyte.

Ne vijim, Z.Defrim Spahiu u ndal ne nenet kryesore qe favorizojne partneritetin, si edhe dhe disa prej tyre qe nuk jane zbatuar as ne nivel te pare, as ne ate te dyte.

Duke bere thirrje per te njohur kontraten kolektive te nivelit te pare, si dhe kerkesat e cdo anetari ne cdo skaj te Shqiperise qe te perfshihen ne Kontrate, jemi te gatshem qe tani te presim verejtjet dhe rekomandimet per kontraten e ardhshme.

Ne fund, Z.Bajram Kruja u tha te pranishmeve se ne vijim gjate ketij viti dhe gjate vitit 2009 do te zhvillohen seminare per te trajtuar ceshtjet qe lidhen me Statutin dhe Kontraten Kolektive, te cilat bejne te mundur veprimtarine demokratike ne mardheniet ndermjet anetareve dhe drejtuesve e forumeve sindikale, si dhe partneritetin social ne nivel te pare e te dyte.

Ilirjana Bresha

Riorganizohet Seksioni Sindikal i SPA ne Durres

Mbas nje pune pergatitore qe eshte zhvilluar gjate periudhes se fundit ne shkollat e rrethit te Durresit, keto dite u riorganizua seksioni sindikal i ketij rrethi, ne krye te te cilit eshte caktuar zoti Alfred Doraci. Ne takimin e pare qe u zhvillua me nje grup sindikalistesh te ketij seksioni, u percaktuan detyrat per vazhdimin e punes organizuese me keshillat sindikale ne shkolla, duke synuar qe ne nje periudhe te pershtateshme, sipas Statutit te SPASH-it, te mblidhet aktivi i ketij rrethi, per te formalizuar strukturat perkatese.

Ne ditet e para te shkolles:

PERSERI U SHPALOSEN FAQET E LIBRAVE TE DITURISE...

1.

Me ne fund, veren e gjate e te nxehte te ketij viti e lame pas. Nxenesit e shkollave 9-vjeçare dhe te gjimnazeve te vendit u rikthyen perseri prane familjeve te tyre. Pushimet i kaluan neper plazhet e bregdetit Adriatik e Jon, prane liqeneve ose ne zonat e thella malore, me blerim te perhershem e uje te kulluar. Si zakonisht, ne ditet e para te shtatorit ata nisen interesimin dhe pergatitjet per vitin e ri mesimor. Nder te tjera, u kujdesen qe te siguronin librat e perzgjedhur sipas lendeve te ndryshme. Ndersa ne media pame qe priteshin shiritat e perurimit te ndertesave te reja shkollore ose te rikonstruktuara. Ja, ne kryeqytet u perurua shkolla 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit, u rikonstruktua shkolla ne Yzberisht, nje shkolle e re u hap ne Shenavlash te Durresit dhe disa te tjera te rikonstrutuara u peruruan ne Tropoje, Korçe etj. Ndersa ne Shkoder çeli dyert per here te pare gjimnazi profesional "Peter Mahringer", me bashkepunimin ndermjet Shqiperise e Austrise. Keshtu mund te rendisnim dhe perurime te tjera te shkollave tona, gje qe do t'i permiresoje me tej kushtet per mesim, edukim e veprimtari te ndryshme me nxenesit. Kujdesi i te gjitheve, i organeve te pushtetit e te arsimit, i prinderve, i sindikatave te arsimit dhe i mbare shoqerise ishte qe sivjet mesimet te nisnin dhe te vazhdonin ne kushte sa me normale



Ja, me 15 shtator 2008, perseri gumezhine mjediset e shkollave tona 9-vjeçare e gjimnazeve, si ne qytete e ne fshatra. Shiu i rrembyer qe ra nuk e pengoi festen e diturise, te dashurise sone te perbashket per shkollen. Ne mes nxenesve te te gjitha moshave, pame te ngazellyer jo vetem prinderit, por dhe mesuesit e tyre te dashur. Secili prej femijeve tane ishte perpjekur te vishej dhe te paraqitej sa me mire. Por i veçante ishte sidomos kujdesi per femijet e kopshteve dhe nxenesit e klasave te para. Nder duar ata mbanin tufa me lule te fresketa dhe ne gji gezimin e natyrshem feminor.

Faqet e para te gazetave dhe

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

emisionet qendrore te radiove e televizioneve u mbushen me kronika nga dita e pare e shkolles. Do te deshironim qe ta percillnim kete atmosfere nga te gjitha shkollat e vendit tone, por kjo gje ishte e pamundur. Pra, ne shkuam vetem ne ndonjeren nga shkollat 9-vjeçare e kopshtet ne kryeqytet.

2.

Ne mengjesin e asaj dite te paharruar per mesuesit, nxenesit e prinderit e tyre, oborri i shkolles 9-vjeçare "De Rada" ne Tirane u mbush si asnjehere tjeter. Ngado qe te hidhje syte, shihje fytyra gazmore, djem e vajza me lule te fresketa e shumengjyrshe nder duar. Por ne krahe kishin dhe çantat e tyre, mbushur me libra te rinj mesimore. Te dukej se ata ishin te paduruar per te pritur çastin, kur perseri do te uleshin nder banka prane njeri-tjetrit dhe do te shpalosnin faqet e tyre, mbushur plot me dituri per jeten. Ja, e shoqeruar nga mami Xhuli, eshte dhe Sofiana, nxenese e klases se dyte, e cila mezi e mban tufen e luleve, qe do t'ia dhuroje meseses se vet.

Neper klasa ka gjalleri te veçante, sidomos nga nxenesit qe sivjet u ulen per here te pare ne bankat e diturise. Ne shkalle vendi, numri i tyre eshte 50 mije. Atyre u rrjedh nga syte edhe ndonje pike loti i vaket, pasi permallohen qe ndahen disa ore nga njerezit e tyre te dashur. Per t'i "ngushelluar", prane u rrijne prinder e gjysher, si te ishin edhe ata "nxenes" e ndonjeri prej tyre mallengjehet me teper. Ne dy klasa te para, ku jane mesueset Mimoza Huta e Nexhi Skrela, ishin nga 31-32 nxenes. Ato mundohen t'i qetesojne me fjalet e tyre te embla nxenes e prinder, duke folur: "Femije te dashur, sivjet do te mesojme bashke gjera te bukura, do te kendojme e do te lozim…".

Po kete mjedis gjetem edhe ne kopshtin e femijeve nr.36, "Kesulekuqja". Se emra te tille te bukur e domethenes mbajne kudo kopshtet tane, si "Lepurushet", "Filizat", "Harabelat", "Nene Tereza" etj. Drejtoresha, Aiushe Sule dhe te gjitha edukatoret jane te gezuara, por dhe pak te tronditura. Ato duan t' qetesojne zemrat e vogla te femijeve, bashke me prinderit, qe i shoqerojne dhe nuk u behet te ndahen nga ata. Ngado qe te hedhesh syte sheh lule shumengjyrshe, por dhe plot lodra te ndryshme, per edukimin dhe argetimin e femijeve. Veçanerisht e shqetesuar ishte edukatorja e grupit te pare, Remzie Islami. Ajo u qendronte prane ne tavolina 25 vogelusheve, te cilet kishin ardhur ate dite. Gjalleri kishte dhe ne grupet e tjere te femijvee, te cilet i lame ne gezimin dhe emocionet e dites se pare.

3.

Shkolla 9-vjeçare me emrin simbolik "7 Marsi", ndodhet afer stacionit te trenit ne Tirane. Megjithese koha ishte me shiun karakteristik te vjeshtes, mjediset e saj gumezhine si asnjehere. Ne diten e pare te mesimeve, si kudo, pati gjalleri te jashtezakonshme. Afer njemije nxenesit e saj, bashke me 40 mesuesit e prinderit, perjetuan gezimin e dites se pare te mesimeve. Ndersa ne shkalle vendi numri i pergjithshe ishte afer 433 mije. Ne mes tyre kishte disa prinder, me aparate fotografike e filmike nder duar, qe donin ta fiksonin sa me mire kete çast te paharruar te jetes se femijeve, niperve ose mbesave te tyre. Pas ceremonise se rastit, nxenesit hyne neper klasa dhe ne shkolle u vendos qetesia. Por eshte e natyrshme qe dita e pare e shkolles eshte me teper dite festive, pra sherben per t'u takuar e per t'u njohur mesues, nxenes e prinder.

Isha prane ketij kolektivi dhe ne diten e dyte te mesimeve. Ra zilja dhe nxenes e mesues hyne neper klasa. Ne njeren prej tyre takuam mesuesin e dalluar Vladimir Kokeri. Te gjithe nxenesit u perqendruan ne fjalet e tij rreth temes se pare, qe zhvilluan. Gjate asaj dite ishin plotesisht te perkushtuara ne detyren e tyre te gjitha mesueset, nder te cilat te permendin per mire Liri Haxhillarin (gjuhe-letersi), Mirela Vishen e Nevila Haxhimalin (ne ciklin e ulet) e te tjera.

Drejtoresha Vitore Deliallisi, nje punonjese e shkathet dhe e pasionuar e arsimit, me tregoi per ecurine e diteve te para te fillimit te mesimeve. Ne fund te qershorit kalueshmeria e nxenesve ishte 97 per qind dhe nota mesatare 7,1. U dalluan kolektivat e klasave 7-B, 8-A, 9-D etj. Ndersa synohet qe kete vit, krahas ruajtjes se kontingjentit te nxenesve, kalueshmeria e cilesia te ngrihen me lart. Veçori eshte se sivjet nisi per here te pare klasa e nente, numri i pergjithshem tek ne eshte 55 mije nxenes. Pe kete qellim, jane marre e do te merren te gjitha masat, duke zbatuar Udhezimin e MASH dhe gjithe legjislacionin perkates. Ndihmese e mire ne kete drejtim eshte se kuadri mesimdhenes i shkolles "7 Marsi" eshte i plote e me arsimin perkates, tekstet u siguruan plotesisht qe ne diten e pare etj. Ndersa lokali eshte rikonstruktuar para 2-3 vjetesh dhe i ka te gjitha mjediset e pershtatshme per mesim, edukim e veprimtari te ndryshme.

Ne ndihme te mesimit dhe edukimit jane vene organizmat e ndryshme ne shkolle. Fjale te mira degjon dhe per drejtuesit e sindikates se arsimit. Veprimtaret e saj, nder te cilet dallohet Vehap Xhafa, bashkepunojne me drejtuesit e shkolles per te gjitha çeshtjet e procesit mesimor-edukativ, brenda e jashte saj. Dhe kjo gje ka qene mjaft frytdhenese. Nder te tjera, ketu te permendin se u organizuan ceremoni mbreselenese, me rastin e daljes ne pension te mesueseve Lida Theodhori e Keti Dede etj. Po keshtu, bordi i kesaj shkolle, me kryetar Ylli Taken, ka ndihmuar ne çdo drejtim, qe eshte paraqitur nevoja. Kjo gje na ndikuar pozitiviesht per vijueshmerine, perparimin, shtimin e bazes materiale dhe veprimtarite e organizuara.

Ne keto institucione arsimore, qe vizituam ne Tirane ne ditet e para te mesimeve, dhe ne te tjera ne mbare vendin, sivjet synohet per kalueshmeri e cilesi me te larte. Po keshtu, do te zhvillohen mjaft veprimtari te ndryshme jashte procesit mesimor. Per t'u shenuar do te jete shfrytezimi i sallave te kompjuterave, pasurimi i bibliotekave etj.


E gjithe shoqeria jone eshte e interesuar dhe punon pa u kursyer qe brezi yne te rritet sa me i ditur dhe i afte per t'iu pergjigjur sfidave te reja te zhvillimeve demokratike ne Shqiperi e te integrimit evropian.

MURAT GECAJ

Të reja shkencore

GJAKU UNIVERSAL

Si donator universal, grupi i gjakut 0 mund t'u jepet personave të të gjithë grupeve të tjerë, duke e bërë atë grupin më me vlerë në bankën e gjakut. Kjo mund të ndryshojë shumë shpejt,



tani që shkencëtarët danezë kanë gjetur një mënyrë për të konvertuar tipe të tjerë gjaku në 0 me ndihmën e disa bakterieve. Shkencëtarët kanë izoluar dy enzima që krijohen nga insektet që mund të tretin molekulat e sheqerit, të cilat bëjnë dallimin midis tipeve të gjakut A, B dhe AB - negativ, duke i kthyer ato në tip 0 (megjithatë, ky bakter nuk mund të eliminojë proteinat Rh që gjenden në gjakun A, B, AB-pozitiv). Testimi i gjakut të tjetërsuar në pacientë njerëzorë sapo ka filluar. Nëse do të rezultojë i suksesshëm, gjaku i transformuar mund të sigurojë një rezervë të dobishme për këdo, në rast nevoje.

MAKINA E PAVARUR

Problemi me shumicën e makinave ekologjike është se ato kërkojnë furnizim rregullisht me hidrogjenin ose etanolin që janë aq të vështira për t'u gjendur. "Venturi Eclectic" mund të



ecë duke përdorur thjesht erën ose fuqinë diellore. Tavani është i përpërë nga një material që thith rrezet diellore dhe turbina e erës i shton fuqinë. Kur këto dy pajisje nuk mjaftojnë, hyn ne funksion nje bateri elektrike, që ndodhet në fund të makinës me tre vende.

AVIONË TË SHKËLQYER

Ka një vit që është hedhur në treg Boeing 787 Dreamliner, po 250 vendshi vazhdon të mbetet avioni më i suksesshëm, nga ana komerciale, në historinë e aviacionit. 50 klientë që dëshirojnë dritare më të mëdha, presion ajri dhe lagështi më të mirë, dhe sigurisht më shumë hapësirë ndërmjet sedileve, kanë porositur 710 avionë me vlerë 120 bilion dollarë. Materiali prej të cilit 787-a përbëhet



bën që ai të jetë më ekologjikë dhe të harxhojnë 20% më pak karburant se të tjerët. Të gjithë ekzemplarët e këtij avioni janë të shitur, deri në vitin 2014.

Këshilla praktike

PESË GABIME TË MËDHA QË PRINDËRIT BËJNË

Të gjithë i duam fëmijët tanë, por, në këtë periudhë, kur të dy prindërit punojnë dhe me orare të vona, kemi tendencën të neglizhojmë dhe t'u biem gjërave për shkurt. Në vijim janë 5 gabime të mëdha që prindërit bëjnë:

1. Llastojnë fëmijët

Nuk ka dyshim që prindërit i duan fëmijët dhe duan që ata të kenë gjithçka. Megjithatë, këto kanë një çmim. Disa prindër kanë llastuar fëmijët e tyre deri në pikën që fëmijët arrijnë të mos jenë më të kënaqur me gjerat që kanë. Kjo bën që ata të duan gjithmonë më shumë, kur ndërkohë gjithçka u nevojitet është vetëm pak kohë me prindërit e tyre. Problemi është që ata nuk do jenë të përgatitur për zhgënjimet gjatë jetës së tyre dhe në të njëjtën kohë nuk do dinë të jenë mirënjohës për gjithçka do kenë.

2. Nuk përfshihen në jetën shkollore të fëmijëve

Shkolla është vendi ku fëmijët tuaj do të kalojnë më shumë kohë se kudo tjetër, përveç shtëpisë; është vendi që ka përgjegjësinë më të madhe për formimin e jetës së tyre. Duke ditur këtë, si mund të mos përfshiheni në jetën shkollore të fëmijëve tuaj? Nuk ka rëndësi nëse jeni ju apo partneri juaj që e bën këtë, familja juaj duhet të ketë një përfaqësues në shkollë. Mos përdorni punën si justifikim. Merrni një ditë pushim, nëse është e nevojshme. Menjëherë do të shihni që është kohë e shpenzuar mirë. Duhet të paktën të keni shkëmbim e-mailesh apo telefonatash me mësuesin, në mënyrë që ai të kuptojë që ju jeni të interesuar për fëmijët tuaj dhe, në të njëjtën kohë, t'ju lajmërojnë për gjithçka ndodh me ta.

3. Nuk u jepni përgjegjësi të mjaftueshme

Fëmijët nuk duhet të presin ndonjë pagesë, nëse bëjnë ndonjë punë të vogël në shtëpi. Është shtëpi, jo hotel. Ata duhet të jenë pjesë e familjes në çdo gjë. Nëse rriten pa patur përgjegjësi mbi vete, si mund të mbajnë një punë ose të arrijnë të mbarojnë universitetin kur të rriten? Ata nuk duhet të konsiderohen as si skllever, por as si me pushime gjatë të gjithë kohës.

4. Nuk mbani premtimet

Nëse i thoni fëmijës që do të shpërblehet nëse pastron kopshtin apo derdh plehrat, do të ishte mirë ta mbanit këtë premtim. Ndonjëherë është e vështirë të mbash mend të gjitha premtimet dhe ndëshkimet, por duhet të kini parasysh që këto metoda bëjnë që të ndërtohet një marrëdhënie me besim. Nëse nuk mbani fjalën tuaj, fëmijët do të mendojnë që gjithçka thoni janë vetëm fjalë. Kjo është më e keqja; ata nuk do të kenë besim te prindërit e tyre.

5. Nuk jeni një bashkëshort/ bashkëshorte i/e mirë

Si e trajtoni partnerin tuaj është shumë e rëndësishme në lidhje me mënyrën se si fëmijët tuaj do të zhvillojnë marrëdhëniet me të tjerë. Nëse nuk e trajtoni mirë partnerin tuaj, ose nëse mënyra juaj e vetme për të bashkëbiseduar është duke bërtitur, po u mësoni fëmijëve tuaj të sillen në të njëjtën mënyrë. Nëse e trajtoni partnerin me dashuri dhe respekt, kjo do t'u tregojë fëmijëve tuaj vlerat e familjes. Gjithashtu kjo do të bëjë që ata të ndiejnë që familja e tyre është një oaz i qetë.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

TRIBUNA SINDIKALE



